



# SOS

# FSHATRA E FËMIJËVE KOSOVË ËSHTË DUKE KËRKUAR



SOS FSHATRA  
E FËMIJËVE  
KOSOVË

## SOS NËNË TRAJNUESE (e angazhuar)

### DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË KRYESORE

- Krijon familje me një atmosferë të ngrohtë dhe të sigurtë dhe jeton së bashku me fëmijët të cilët rriten si vëllezër dhe motra;
- Organizon në mënyrë të strukturuar jetën familjare duke mundësuar pjesëmarrjen aktive të gjithë fëmijëve që ka nën përkujdesje, varësisht nga mosha dhe mundësitë e tyre;
- Ofron përkujdesje, edukim dhe krijon marrëdhënie stabile me fëmijët e SOS Fshatit;
- Krijon marrëdhënie stabile si dhe siguron zhvillim dhe mirëqenie të gjithëmbarshme të secilit fëmijë në familjen e saj;
- Si profesioniste në përkujdesjen e fëmijëve bashkëpunon me anëtarët e tjerë të personelit përkatës për t'iu përgjigjur nevojave të fëmijëve;
- Reflekton rregullisht sjelljet dhe praktikat vetanake dhe udhëheq zhvillimin e vet profesional dhe personal;
- Identifikohet me vlerat, vizionin dhe misionin e organizatës si dhe përmbush standardet kualitative të organizatës.

### KRITERET

- Statusi martesor: Kandidatja mund të jetë e pamartuar, e vejë apo e shkurorëzuar apo edhe nënë vetë-ushqyese e cila mund të ketë një fëmijë;
- Edukimi: Nivel i mesëm i edukimit;

- Përvojë paraprake në angazhimin në fushat lidhur me përkujdesjen ndaj fëmijëve dhe edukimin;
- Shëndet të mirë fizik dhe mendor.
- Gadishmëri të jetoj në SOS Fshatin e Fëmijëve dhe të angazhohet për periudhë të gjatë kohore (së paku të përkujdeset për një gjeneratë të fëmijëve);
- Gadishmëri që përmes procesit të trajnimeve profesionale dhe zhvillimit të vazhdueshëm të arrijë njohuritë dhe shkathtësitë e domosdoshme për angazhim;
- Shkathtësi organizative, interpersonale dhe komunikuese dhe fleksibilitet në qasje dhe punë nën presion;
- Trajnime shtesë në fushën e përkujdesjes dhe edukimit të fëmijëve;
- Njohuri bazike për të Drejtat e Njeriut/ Fëmijëve;

### NE OFROJMË

- Pagën e 13-të;
- Pushimin vjetor të paguar 37 ditë angazhimi;
- Banim në shtëpi të mobiluar pa pagesë qiraje, rryme, uji, nxemje dhe ushqimi;
- Trajnime të ndryshme për ngritje profesionale;
- Pushime verore me fëmijët e fshatit me shpenzime të mbuluara nga organizata;
- Angazhim afatgjatë dhe të sigurtë.

Dokumentacioni i nevojshëm: Aplikacioni (miret në zyrat tona apo mund të shkarkohet nga webfaqja zyrtare: [www.soskosova.org](http://www.soskosova.org)); CV; Letër motivimi; Kopje të Diplomave, Çertifikatave, Referencave, Vertetimi nga gjykata se nuk jeni nën hetime. Afati i fundit për dorëzim është më 25.10.2018 deri në orën 16.00. Vetëm kandidatët e listës së ngushtë ftohen në intervistë.

Për informata shtesë, ju lutem kontaktoni: SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë, rruga: "1 Tetori" p.n. Velani-Prishtinë 10000, email [info-cv@soskosova.org](mailto:info-cv@soskosova.org) dhe tel/fax: 038-516-977

SOS Fshatrat e Fëmijëve është një organizatë jo-qeveritare dhe jo-profitabile, e zhvillimit social, aktive në fushën e të drejtave të fëmijëve që nga viti 1999, duke i mbështetur nevojat brengat e fëmijëve në nevojë dhe pa përkujdesje prindërore, ne ndihmojmë zhvillimin e tyre në komunitet, duke u përkushtuar në ofrimin e shtëpisë dhe familjes për fëmijët pa përkujdesje prindërore, si dhe përgaditjen e tyre për një jetë të pavarur. Për të përmbushur këtë përgjegjësi, na nevojitet një SOS Nënë e përkushtuar.